



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 6, datë 30.12.2015

PËR

NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 1, DATË 30.07.2015 “PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE QË DO TË NDIQEN NGA
AUTORITETET E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE
PËR LEJE NDËRTIMI DERI NË MIRATIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME
VENDORE”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Agjencisë së Zhvillimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 1, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e Zhvillimit të Territorit për shqyrtimin e kërkesave për Leje Ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, bëhet ndryshimi dhe shtesa si vijon:
 - a) Gërma f) e pikës 2 zëvendësohet me fjalinë si më poshtë:
 - f) shtesa në banesa individuale/njëfamiljare ekzistuese, duke respektuar kushtet urbane sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.
 - b) Në pikën 2 pas gërmës f) shtohet gërma g) me përmbajtje si më poshtë:
 - g) shtesa në komplekse rezidenciale me “vila individuale”, deri në masën 25 % të sipërfaqes totale të ndërtimit, duke respektuar kushtet urbane sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI



MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN

SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA



DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT